REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr.8171/1 Prot

Lushnje,më 18.09.2025

PROJEKT- VENDIM

NR87 DATË18/09/2025

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË VKB -SË NR 44, DATË 30.05.2007 DHE MIRATIMIN E VENDQËNDRIMEVE TË REJA PER TAKSI 4+1,8 +1 DHE TË AUTOBUZËVE"

Në zbatim të Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " i ndryshuar,kreu VII ,neni 23 pika 6, Ligjit nr 8308 datë 18..03.1998 " Për transportet rrugore" të ndryshuar ,kreu II.4, neni 35 , Ligjit nr 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar , neni 7 ,pika f ,Udhëzimit Nr 1649 datë 16.08.1999 "Mbi plotësimin e disa kushteve të vecanta në transportin rrugor të udhëtarëve ", të ndryshuar ,kreu III, pika 2, si dhe propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për riorganizimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi 4 +1, 8+1 dhe autobuzëve :

PROPOZOJMË:

1- Të miratojë shfuqizimin e VKB-së NR 44 ,datë 30.05.2007 " Mbi miratimin e vendqëndrimeve të taksive 4+1 8+1 dhe të autobuzëve".
2- Të miratojë vendqëndrimet e reja të mjeteve taksi 4+1 ,8+1 dhe autobuzave sipas tabelës bashkëngjitur.
3 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike,Drejtoria e Policisë Bashkiake , si dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike për realizimin e sinjalistikave horizontale dhe vertikale për vendqëndrimet e miratuara.

DREJTOR I DR.JURIDIKE
BEDRI HIDA

KRYETAR I BASHKISË
ERISELDA SEFA

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SËSHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 221390 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr.8171 Prot

Lushnje,më 18.09.2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË VKB-SË NR 44, DATË 30.05.2007 DHE MIRATIMIN E VENDQENDRIMEVE TË REJA PER TAKSI 4+1,8 +1 DHE TË AUTOBUZËVE"

Të nderuar Këshilltarë ,

Mbështetur në Ligjin Nr 8308 datë 18.03.1998 " Për transportet rrugore", të ndryshuar , Ligji 8378 datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i RSH" neni 7 , pika f; Udhëzimin Nr.1649 datë16.08. 1999 "Mbi plotësimin e disa kushteve të vecanta në transportin rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar ; si dhe Ligjin Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " ku përcaktohet se këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij shërbimi brenda territorit të vet ,përfshirë edhe vendqëndrimet e mjeteve taksi 4+1 8+1 dhe autobuzëve.

Ky relacion ka për qëllim të paraqesë analizën , arsyetimin dhe bazën ligjore që mbështet nevojën për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.44, datë 30.05.2007 , dhe për miratimin e vendqëndrimeve të reja për mjetet e shërbimit taksi (4+1 dhe 8 + 1) si dhe për linjat e autobuzave në territorin e Bashkisë Lushnje .

ARSYETIMI PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË VKB-SË NR.44, DATË 30.05.2007

Vendimi Nr 44 , datë 30.05.2007 i Këshillit Bashkiak dhe pse ka qënë i vlefshëm në kohën e miratimit , sot nuk i përgjigjet më zhvillimeve aktuale urbane ,sociale dhe infrastrukturore të qytetit .Shfuqizimi i këtij vendimi dhe miratimi i një vendimi të ri është i domsdoshëm për arsyet sim ë poshtë:

- Vendimi ekzistues është i vitit 2007 dhe për pasojë nuk përputhet në raport me zhvillimet bashkëkohore të qytetit ;
- Numri i mjeteve të transportit publik është rritur ndjeshëm , duke kërkuar më shumë vendqëndrime të shpërndara në mënyrë funksionale ;
- Investimet infrastrukturore të kryera ndër vite kanë bërë që disa nga vendqëndrimet e përcaktuara në vendimin e vjetër të jenë aktualisht të pamundura për funksionim.
- Zona të dendura të qytetit nuk janë të mbuluara me vendqëndrime , duke sjellë probleme në aksesin e qytetarëve dhe në organizimin urban.
- Nevoja për përafrim me planet e zhvillimit të mobilitetit urban dhe strategjitë vendore të qarkullimit të qëndrueshëm

Drejtoria e Shërbimeve Publike , në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë Lushnje , ka realizuar një analizë të hollësishme dhe të mirëstrukturuar të situatës aktuale në terren lidhur me funksionimin e vëndqëndrimeve ekzistuese të mjeteve të transportit publik.Kjo analizë ka përfshirë verifikime fizike në zonat urbane dhe hyrje daljet kryesore të qytetit , monitorimit e fluksit të udhëtarëve , vështirësitë të hasura nga drejtuesit e mjeteve taksi dhe autobuzëve, si dhe studimin e impaktit të investimeve infrastrukturore të kryera ndër vite mbi funksionalitetin e pikave egzistuese.
Në kuadër të kësaj pune përgatitore , është zhvilluar gjithashtu dëgjesë publike me përfaqësues të operatorëve të transportit publik, përfshirë subjektet që operojnë me mjete taksi 4+1 dhe 8 +1 .dhe autobuzve. Ku u mbajt dhe procesverbali me Nr 7305 Prot datë 26.08.2025.

Gjatë kësaj dëgjese u diskutua për problematikat aktuale , propozimet për përmirësim , si dhe nevojat e tyre për vendqëndrime të përshtatshme dhe të aksesueshme .

Të gjitha këto informacione janë marrë në kosideratë për hartimin e këtij relacioni me qëllim që vendimarrja të mbështetet në një analizë reale , gjithpërfshirëse dhe në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Në vijim të këtij vlerësimi , propozojmë vendosjen e vendqëndrimeve si më poshtë:
Vënqëndrimet të propozuara për taksitë 4+ 1 8+1

1- **Stacioni i Trenit 2 venqëndrime për taksi 1 (4+1) dhe 1 8+1)**
Pikë stragtegjike për pasagjerët që vijnë me transport interurban ,zone me lëvizshmëri të lartë , pike hyrëse dalëse me qytetin.

2- **Në rrugën "Kongresi " Poliklinika (2 vendqëndrime) 4+1**
Poliklinika e Lushnjes është një qëndër e rëndësishme për kujdesin shëndetësor në qytet ,me shërbime specilistike dhe frekuentim të lartë të qytetarëve dhe banorët e zonave fqinjë,.Rrjedhimisht , janë të nevojshme vendqëndrime që lehtësojnë transportin e pacientëve

3- **Në rrugën "Kongresi'' pranë qëndres tregtare LC Waikiki (2 vendqëndrime 4+1)**
Zona përrreth përbën një pike qëndrore administrative dhe tregtare te qytetit , pranë ndodhen instuticione publike të rëndësishme

4- **Rruga " Rrahman Uruçi" Pranë spitalit "IHSAN CABEJ" (2 vendqëndrime taksi 4+1)**

Spitali Ihasan Çabej është instuticioni kryesor shëndetësor në qytet dhe ofron shërbime 24/7 për mijëra banorë nga qyteti dhe zonat rurale përrreth , ka nevoje të vazhdueshme për mjete transporti të menjëhershëm për pacientë që vijnë e largohen pas vizitave , për personat e moshuar etj

5- **Në rrugën "Fan Noli", në lagjen Çlirimi, Lushnje . (4 vendqëndrime taksi 4+1)**

Kjo zone është qendër shumë funksionale dhe me levizshmëri të lartë ,një nga segmentet më të frekuentuara të qytetit , ku ndërthuren funksione kulturore dhe instuticionale .Kjo e bën një nyje të rëndësishme për levizjen e qytetarëve në cdo orar të ditës.

6- **Në rrugën "Fan Noli" Pranë gjykatës Administrative Lushnje (1 vendqëndrim taksi 4+1)**

Zonë me aktivitet institucional, që frekuhentohet përditë nga qytetaret e ardhur nga rrethet dhe fshatrat .

7- **Rrotondo e Plasmasit (2 vendqëndrime taksi 4 +1)**

8- **Pranë Varrezave të Deshmoreve(1 vendqendrim taksi 4+1)**

9- **Tek Rruga Misto Mame pranë Furrës së Bukës Pero 2 (2 vendqëndrime 4+ 1, 8+1)**

10- **Tek Rruga Misto Mame pranë Furrës së Bukës Pero 1(2 vendqëndrime 4 +1)**

Vënqëndrimet të propozuara për Autobuzët :

1- **Stacioni i trenit 12 vendqëndrime**

6 vëndqëndrime për linjat ndërqytetëse dhe 6 rrethqytetës.

2- **Rruga "Pavarsia" (tek ypsiloni) 1 vendqëndrim rrethqytetës**

3-Bulevardi "Kongresi i Lushnjes" pranë Stadiumit Roza Haxhiu (4 vendqendrime autobuz)

Këto vendqëndrime do jënë në funksojn për linjat rrethqytetëse Fiershegan, Allkaj, Karbunarë e Vogël

4- **Rruga "Fan Noli" te parkimi pranë Kinoteatrit (3 venqëndrime autobuz)**

Këto vendqëndrime do jënë në funksion për linjat Rrethqytetëse Hysgjokaj , Ballagat

Duke Ju falenderuar,

Konc: Snl për Transportin&Licensat profesionale
Xh. Tosku

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE
ELTON KOROVESHI

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com